



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. _____ prot.

Elbasan, më _____.____.2020

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Për: **“Zeqiri” sh.p.k.** me adresë: lagjja "Bishanak", rruga "Skëndërbeu", Fier.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim – Marrëveshje Kuadër.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje pllaka varri për Agjencinë e Shërbimeve Publike” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat **12 muaj**, me fond limit **2,685,100** (dymilion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e njëqind) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2020 dhe 2021. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Shumatorja e çmimeve për njësi: **4,882** (katërmijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) **lekë pa tvsh.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-66328-07-22-2020

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme X çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Aged” sh.p.k. me Nipt: J 62903344 B

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **4,700** (katërmijë shtatëqind) **lekë** (pa tvsh).

2. “BAÇI – EL 2003” sh.p.k me Nipt: K 42724211 C

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **4,690** (katërmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

3. “Ervin Luzi” p.f. me Nipt: K 71707007 Q

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **4,320** (katërmijë e treqind e njëzet) **lekë** (pa tvsh).

4. “Zeqiri” sh.p.k. me Nipt: J 67902827 A

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **4,470** (katërmijë e katërqind e shtatëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Ofertuesi “Ervin Luzi” p.f. me Nipt: K 71707007 Q

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Ofertuesi “Ervin Luzi” p.f. skualifikohet për arsye se: Ky operator ekonomik kishte mangësi në dokumentacionin e paraqitur e konkretisht:

1.1. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: Operatori ekonomik duhet të **disponoje një kamion me tonazh 3.5 deri 7.5 ton** për transport të mallrave objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- **Aktin e pronësisë së mjetit perkatës;**
ose
- **Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin perkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të trete për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Operatori ekonomik, në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur dokumentacion jo të plotë për automjetin e marrë me qira pasi mungon vërtetimi që ka paguar taksat vjetore si dhe leja e transportit për këtë automjet.

2.1 Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: Operatori Ekonomik duhet të disponoje në pronësi, ose me qira ose të ketë kontratë noteriale furnizimi për "Linje prodhimi Elemente Betoni".

Operatori Ekonomik, në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur një kontratë furnizimi me subjektin "Gazmir Kasa" p.f., ku objekt i kontratës është furnizimi me "Linjë prodhimi

Elemente Betoni dhe për Impiant Inertesh”, por për një prokurim me objekt dhe numër reference tjetër.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]

Në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. “Zeqiri” sh.p.k. me Nipt: J 67902827 A

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **4,470** (katërmijë e katërqind e shtatëdhjetë) **lekë** (pa tvsh).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 26.08.2020

Ankesa: Nuk ka pasur

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Irland Sina**